

VENDIM
Nr. 24, datë 13.1.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 245, DATË 24.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE E TË SHITESAVE MBI PAGË TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË NË AGJENCINË SHETËTËRORE TË KADASTRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 245, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - b) lidhja nr. 2, që përmendet në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2022, përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për këtë vit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.
3. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Lidhja nr. 1

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Titullar i institucionit	I-a	1	20.000
Zëvendëstitullar i institucionit, Drejtor njësie	I-b	1	20.000
Drejtor drejtorie	II-b	1	20.000
Përgjegjës sektori	III-a	1	18.000
Përgjegjës sektori që lidhen me procesin e informatizimit	III-a	1	20.000
Koordinator	III-a/1	1	18.000
Specialist në pozicionet që lidhen me procesin e	III-b	1 ose 2	20.000
	IV-a	1 ose 2 ose 3	

informatizimit			
Specialist	III-b	1 ose 2	18.000
	IV-a	1 ose 2 ose 3	

Lidhja nr. 2

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit	Shtesa për kushte pune
Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së parë	III-a	1	20.000
Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë	III-a/1	1	18.000
Zëvendëstitullar i drejtorive vendore të kategorisë së parë	III-a/1	1	18.000
Zëvendëstitullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë	III-b	1	18.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë vendore të kategorisë së parë	III-a/1	1	18.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë	III-b	1	18.000
Përgjegjës sektori në drejtoritë vendore të kategorisë së parë	III-b	1	18.000
Përgjegjës sektori në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë	IV-a	1	18.000
Titullar i zyrës vendore	IV-a	1	18.000
Specialist në drejtoritë vendore të kategorisë së parë	IV-a	1 ose 2 ose 3	18.000
Specialist në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë, Specialist në zyrat vendore	IV-b	1 ose 2 ose 3	18.000

Kategorizimi i drejtorive vendore është si vijon:

- Kategoria e parë: drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tirana Rurale 1, Tiranë Rurale 2, Vlorë, Fier, Kamzë–Vorë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Berat, Kavajë, Gjirokastrë, Krujë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Dibër, Kukës dhe zonat e stimuluar.

- Kategoria e dytë: drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kuçovë dhe Tepelenë.